



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:812/26, Datë: 28.05.2026

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregullores (AKA) nr. 02/2025 për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 149 të mbajtur më 18.05.2026, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimeve të Universitetit të Prishtinës - **Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë** për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2026 – 30 shtator 2029):
 1. *Shkenca Bimore, MSc 120 me kuotën maksimumi 10 studentë për vit akademik;*
- II. Numri i studentëve aplikohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Universiteti i Prishtinës - **Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë** që deri më datë 30.09.2026 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti i Prishtinës - **Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë** të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet me vendim, vetëm nga KShC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti i Prishtinës - **Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë** brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Shkenca Bimore, MSc 120	Skender Kaciu Dukagjin Zeka

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Prishtinës – **Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë**. Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit; Shkenca Bimore, MSc 120 vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar me datë 30.03.2026.

Ekipi i ekspertëve në raportin final me rekomandime ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht gjashtë (6) fusha të standardeve të akreditimit;

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 149-të, të mbajtur më datë 18.05.2026, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë dhe duke u bazuar në raportet e ekipit të ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit pas realizimit të vizitave si dhe rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtare të vlerësimit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës – Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

